SHABAN ÇUPI

PORTRETE DËSHMORËSH:

NURI BUSHI E XHEMSEDIN SUMA

Cilat ishin pikat e përbashkëta të dëshmorëve Nuri Bushi e Xhemsedin Suma?

Fjalim në 20 vjetorin e rënies së Dëshmorëve

Dëshmorët Nuri Bushi e Xhemsedin Suma, që të dy janë nga treva e Hanit të Elezit. Ishin të një moshe dhe të një gjenerate shkollore.Që të dy kishin të kryer shkollën e mesme. Pas vitit 1990 që të dy punonin në Itali dhe ishin aktivistë të dalluar të Shoqatës ,,Iliria'' e cila me kontributet e saja ndihmonte mbijetesën në Kosovë. Që të dy rrjedhin nga familje kombëtare, Nuri Bushi ishte kusheriri i heroit të Kosovës Ismail Raka i cili u mbyt në torturë nga policia serbe më 29 nëntor 1994, ndërsa Xhemsedin Suma është i vëllau i Rufki Sumës, i cili ishte komandant i Brigadës 164,,Gafurr Loku'' të UÇK-së. Që të dy, në hierarkinë ushtarake ishin komandant

togu dhe me sukses udhëhiqnin ushtarët në betejë, që të dy ishin të martuar dhe kishin fëmijë dhe ndërmjet dashurisë familjare dhe lirisë së Kosovës, ata zgjodhën këtë të dytën, pra lirinë e Kosovës. Që të dy ishin pjesëmarrës të betejës së parë kundër forcave serbe më 26 shkurt 1999 në Puset e Nikës. Në luftë për liri, ranë brenda pak orëve; Nuriu me 2 mars 1999, ndërsa Xhema me 3 mars 1999, që të dy ranë nën emblemën e UÇK-së dhe nën kushtrimin liridashës: Marsi sjell pranverën, ndërsa pushka sjell lirinë!

Varrimi i tyre u bë në rrethana të rënda lufte; Xhemsedini u varros në varrezat e qytetit në Ferizaj nën përkujdesjen e Fatmir Gashit, pasiqë forcat serbe ia morën trupin e pajetë. Xhema u varros me pjesmarrje të shumë qytetarëve ferizajas dhe të Hanit të Elezit. Nuriu, fillimisht varroset në varrezat e lagjes Brava në

Puset e Nikës me pjesëmarrje të bashkëluftëtarëve të tij dhe fjalimin ushtarak për jetën dhe veprën heroike të dëshmorit e mbajti Mehmet Ballazhi, zv.komandant i Brigadës 164. Më 29 gusht 1999 u bë zhvarrimi i tyre dhe u varrosën në varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës, krahas dëshmorëve të tjerë dhe fjalim mortor e mbajti komandanti i Brigadës 164 ,,Gafurr Loku'' të UÇK-së, Rufki Suma.

Beteja e 2 e 3 marsit 1999, 20 vite më vonë, kujtohet si një ngjarje e madhe me vlera të rralla historike në luftë për liri dhe te gjeneratat e reja ruhet si një trashëgimi e madhe kombëtare e brezave. Sa herë që vie marsi dhe saherë që do të përmenden këto data, do të na kujtohen dëshmorët Xhemsedin Suma e Nuri Bushi dhe me këto vlera do të mbesin në kujtesën tonë popullore dhe si të tillë po ia përcjellim edhe historisë. Po

në këtë datë, krahas rënies së Nuri Bushit e Xhemsedin Sumës, kemi edhe ushtarë të tjerë të plagosur rëndë, si Murat Lokun e Mehmet Lubishtani si dhe zënien rob të ushtarit më të ri të Brigadës, Suad Brava, i cili pushkatohet në burgun e Dubravës më 22 maj 1999.

Vendet se ku ranë Xhemsedin Suma e Nuri Bushi, tanimë janë shndërruar në vende altari, Xhemsedini ra ,,Te antena'' sikur Hektori që mbronte Trojen e tij të dashur, ndërsa Nuriu, ra në Kodër të Faslisë dhe vendi i rënies së tij na e kujton shqiponjën dhe luftën e saj me gjarpinjë.

Emrat e dëshmorëve Nuri Bushi e Xhemsedin Suma, tanimë janë trashëguar në familjet e tyre, madje vajza e Nuri Bushit e mori emrin e babait të saj dëshmor. Tanimë, vajzat e dëshmorëve Nuri Bushi e Xhemsedin Suma: Elvana, Nuria e Mevlani,

aktualisht (2019), janë studente të dalluara të Universiteteve të Kosovës, dhe shumë të respektuara në vendin ku jetojnë e veprojnë.

Rënia e dëshmorëve Nuri Bushi dhe Xhemsedin Suma, përkundër dhembjes së madhe, tek ushtarët e UÇK-së, solli mobilizim të ri, solli një moral edhe më të madhë, solli një organizim edhe më të fuqishëm. Në Kodrën e Puseve të Nikës u hapën istikame të thella e të gjata dhe u ndërtuan shumë bunker nëntokësor, me të vetmin qëllim, jo vetëm për t`i bërë ballë luftës, por edhe për ta fituar atë. Numri i ushtarëve u rrit në masë Brigade dhe një pjesë e Brigadës veproi edhe në anën tjetër të lumit, pra në fshatin Gjergjedell me komandant Emrush Sumën duke korrur suksese ushtarake edhe andej lumit.

Betejat tjera që u zhvilluan nga Brigada 164 ,, Gafurr Loku’’ e UÇK-së

deri më 11 qershor 1999, të gjitha ishin të suksesshme dhe secila ka rëndësinë e saj historike, por kësaj radhe shkëputëm për trajtim vetëm betejën e 2 e 3 marsit, pasiqë na ndërlidhin me rënien heroike të Xhemës dhe Nurisë.

Marrë në tërësi, lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në trevën e Hanit të Elezit ishte plotësisht e suksesshme dhe rruga e sajë e lavdisë, solli edhe çlirimin e kësaj komune më 11 qershor 1999, ndërsa dëshmorët e kësaj komune, përgjithmonë mbetën floriri ynë kombëtarë.

Me vendim presidencial të Republikës së Kosovës, Nuri Bushi e Xhemsedin Suma janë shpallur heronjë.

I përjetshëm qoftë kujtimi për dëshmorët Nuri Bushi e Xhemsedin Sumën!

Lavdi dëshmorëve të kombit!

Lapidari i varrezave të dëshmorëve,

Puset e Nikës

Fasha e dëshmorit Nuri Bushi me të cilën lidhi plagën vdekjeprurëse

Dëshmori Xhemsedin Suma me uniformën e UÇK-së

Pllakë përkujtimore në Kodër të Faslisë
ku ka rënë dëshmori Nuri Bushi

Pllakë përkujtimore për dëshmorin Xhemsedin Sumën në vendin e rënies

Te Antena